

Qendra burimore për Mesim dhe Këshillim



**PËRPARIMI**  
Prishtinë

# MATERIALE TË PRODHUARA DHE TË MODIFIKUARA PËR MËSIMDHËNIE DHE MËSIMNXËNIE

(Të krijuara nga vetë mësime dhënëset)

Prishtinë, 2018



*Qendra burimore për Mësim dhe Këshillim*

**PËRPARIMI**

*Prishtinë*

**MATERIALE TË PRODHUARA DHE TË MODIFIKUARA  
PËR MËSIMDHËNIE DHE MËSIMNXËNIE  
(TË KRIJUARA NGA VETË MËSIMDHËNËSET)**

**PRISHTINË, SHKURT**



**MËSUESI MESATAR TREGON.  
MËSUESI I MIRË SHPJEGON.  
MËSUESI SUPERIOR DEMONSTRON.  
MËSUESI I SHKËLQYER INSPIRON.**

**ETËM MËSUESI ËSHTË AI I CILI  
GJËRAT E VËSHTIRA I BËN TË LEHTA**

**UNË DËGJOJ... UNË HARROJ.  
UNË SHOH... UNË MBAJ NË MEND  
UNË E BËJ .... UNË E KUPTOJ**



## PERMBAJTJA

PO DHE JO	9
Puzle me foto	10
Ndërtimi i formave gjeometrike	11
Format gjeometrike me material të butë	12
Bashkimi fotos me objekt dhe me fjalë	13
Formimi i formave të ndryshme me rruaza	14
Kutia me forma	15
Ena me miell misri	16
Lidhja e fotove me fjalë	17
Pastrimi i duarve	18
Shkopinj të me ngjyra	19
Loja me lidhësa	20
Loja me pulla	21
Mbërthimi dhe zbërthimi i pullave	22
Trupi im	23
Akulllore me numra	24
Pjesët e lules	25
Dhëmbë të shëndoshë	26
Libri me numra dhe elemente	27
Format Gjeometrike	28
Leximi me shirit rrëshqitës (titër)	29
Plotësimi i fjalës	30
Mollëkuqja	31
ORA	32
Numrat me ngjyra	33
Kafshët shtepiake dhe të egra	34
Tiketa me fjalë dhe fjali	35
Bashkimi i rrokjeve	36
Klasifikimi i emrave	37
Tabela me fusha	38
Tregimi me tiketa	39

Bashkimi i rrokjeve me penj	40
Ditët e javës	41
Dje, sot, nesër	42
Stinët dhe muajt	43
Dora treguese	44
Shoqërimi i fjalëve	45
Lidhja e përemrit me foljen	46
Ora kërkon orën	47
Vjeshta e artë	48
Alfabeti i gjuhës angleze	49
Loja me numra	50
Numrimi me elemente	51
Fusha me top pingpongu	52
Numrat me elemente	53
Domino me forma	54
Sekretet e bredhit	55
Mollëkuqja me numra	56
Tabela me numra	57
Akrepat e orës	58
Paraardhësi dhe pasardhësi i numrave	59
Shoqërimi i numrave me fjolla bore	60
Domino – mbledhje	61
Mbledhje dhe zbritje - rezultatet me penj	62
KALENDARI	63
Tabela e shumëzimit	64
Busulla orientuese	65
Koncepti i numrit	66
Më e madhe më e vogël	67
Tabela për llogaritje	68
Zbulimi i figurës	69



## HYRJE

Doracaku “ Materiale të prodhuara dhe të modifikuara për mësimdhënie dhe mësimnxënie” është hartuar nga mësimdhënësit e Qendrës Burimore për Mësim dhe Këshillim “Përparimi” në Prishtinë. Procesin e hartimit të këtij doracaku e kanë udhëhequr ekipi për prodhim të materialeve në kuadër të njësisë së mbështetjes.

Qendra burimore është institucion arsimor që funksionon drejtpërdrejt nën administrimin e MASHT-it dhe ka për qëllim edukimin dhe arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Qendra burimore ka dy njësi kryesore:

1. Shkolla speciale për nxënësit me aftësi të kufizuara, të rënda dhe të shumëfishta
2. Shërbimet e mbështetjes për ofrimin e mbështetjes së shkollave të rregullta në mësimdhënie për nxënësit me nevoja të veçanta

Në kuadër të dy njësisë të qendrës burimore, funksionojnë shërbimet e mbështetjes: ekipi për prodhim të materialeve, ekipi për trajnime, ekipi për vlerësim pedagogjik, mësimdhënësit udhëtues, pedagogu dhe psikologu. Këto ekipe bashkëpunojnë për të shkëmbyer njohuritë, ekspertizën, informatat, hulumtimet dhe burimet së bashku me mësimdhënësit e njësisë së arsimit special për ofrimin e shërbimeve më cilësore. Ndër shtyllat kryesore të shërbimeve të mbështetjes janë mësuesit udhëtues të cilët krijojnë rrjete bashkëpunimi në mes të qendrës burimore dhe shkollave të rregullta.

Roli i Qendrës burimore është ofrimi i shërbimeve profesionale për mësimdhënësit në funksion të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies në punën me nxënësit me nevoja të veçanta dhe me ata me vështirësi në të nxënë të përfshirë në sistemin arsimor.

Ky doracak do të ndihmojë në përmbushjen e misionit të Qendrës burimore, do të nxisë mësimdhënësit në shprehjen e kreativitetit të tyre, në modifikimin dhe prodhimin e materialeve të ndryshme didaktike që hyjnë në funksion të procesit cilësor e mësimor, si dhe në përdorimin e tyre në situata të ndryshme mësimore, në varësi me kërkesat didaktike të punës me nxënësit me nivele të ndryshme mësimore.

Me qëllim të ngritjes së cilësisë në procesin e drejtpërdrejtë të mësimdhënies me fëmijët me



nevoja të veçanta, mësimdhënësit e Qendrës burimore në vazhdimësi bëjnë përshtatjen e materialeve bazuar në vlerësimin e nevojave individuale të nxënësve.

Materialet e këtij doracaku përdoren si pjesë e organizimit të mësimin të nxënësve, ku varësisht nga rezultatet e pritshme bëhet edhe përzgjedhja e materialeve didaktike për realizimin e tyre. Këto materiale janë burim i punës praktike të mësimdhënësve me nxënës në klasë.

*Materialet e këtij doracaku ndihmojnë në mësimdhënie dhe mësimnxënie bazuar në Planin Individual të Arsimit –PIA-së, sipas lëndëve mësimore dhe fushave të aktiviteteve:*

- Fusha e zhvillimit të gjuhës dhe komunikimit
- Fusha e zhvillimit të njohës
- Fusha socio-emocionale
- Fusha e zhvillimit fizik
- Fusha e shkathtësive të jetës së përditshme

Për prodhimin e këtyre materialeve janë përdorur kryesisht materiale si: letër, ngjyra, fletë plastifikuese, velcro, materiale ricikluese dhe të tjera. Për secilin material janë dhënë udhëzime të mënyrës së prodhimit të materialit dhe mënyrës së përdorimit në punën me nxënës. Megjithatë shumë nga materialet mund të përdoren në forma dhe mënyra të ndryshme dhe kanë më shumë se një funksion të përdorimit. Kjo bëhet varësisht nga nevojat e punës me nxënës dhe i përket mësimdhënësit që të jetë kreativ në përdorimin e tyre.

Shpresojmë që ky doracak do të jetë një udhëzues i mirë për mësimdhënësit e shkollave të rregulla, për prindërit, por edhe për mësimdhënësit e qendrave tjera burimore për Mësim dhe Këshillim në Kosovë.

# PO DHE JO

## REZULTATET

- Dallon ngjyrat
- Përgjigjet me Po dhe Jo
- Komunikon me simbole

## NDËRTIMI

Përzgjedhim simbolet me ngjyra si në fotografi, printohen dhe plastifikohen në dy kopje. Prehen në katrorë të përshtatshëm varësisht nga nevoja e përdorimit.


## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Simbolin e përgjigjes PO e vendosim në dorën e djathtë, ndërsa simbolin e përgjigjes JO e vendosim në dorën e majtë. Marrim gjërat që nxënësi pëlqen ( mund të jenë lodra, ushqime ose ndonjë aktivitet i preferuar ) dhe e nxisim që pas pyetjes që ne i bëjmë të ngritë dorën me simbolin PO, kur dëshiron të marrë atë që do. Pasi të përvetësojë përgjigjen PO, veprojmë njëjtë edhe me përgjigjen JO, por tani para nxënësit marrim gjëra që ne e dimë sigurt që

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër me ngjyrë
- Marker
- Fletë plastifikuese
- Gërshërë

ai nuk i dëshiron. Nëse është e nevojshme fillimisht i japim shtytje fizike duke i ndihmuar të ngritë dorën, pastaj edhe shtytje verbale duke ju referuar edhe simbolit (p.sh ngrite dorën me simbolin PO, me ngjyrë të gjelbër apo ngrite dorën me simbolin JO, me ngjyrë të kuqe ) që njëkohësisht e ngrit edhe mësuesja. Më pas aktivitetin e vazhdojmë me të dy simbolet paralelisht. Pasi nxënësi t'i ketë kuptuar konceptin PO dhe JO mund ta gjenalizojmë me kërkesa të ndryshme në klasë. Ky aktivitet përdoret kryesisht për nxënësit që nuk kanë komunikim verbal.





# PUZZLE ME FOTO

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër e bardhë
- Fletë pastifikuese
- Gërshërë


## REZULTATET

- Koordinon pjesët
- Njeh numrat 1 - 10 si simbol

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Nxënësi bën bashkimin e pjesëve puzzle për të formuar fotografinë e plotë. Numrat

nga 1 deri në 10 luajnë rol orientues dhe përforcues për nxënësit që njohin numrat. Për nxënësit të cilët nuk njohin numrat, mësimdhënësja vendos një tjetër fotografi të printuar si shabllon orientues dhe vetëkorrigjues për nxënësin.





# NDËRTIMI I FORMAVE GJEOMETRIKE

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letra me ngjyrë
- Gërshërë
- Tel me ngjyra
- Shpuese letre

## REZULTATET

- Njeh format gjeometrike
- Koordinimi sy - duar
- Zhvillon shkathtësitë e motorikes fine

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

### NDËRTIMI

Letrat me ngjyrë i plastifikojmë dhe i presim në forma të ndryshme Pasi t'i presim, me makinë shpuese në skaje të formave hapim vrimat. Teli i mbërshtjellur me material të butë na duhet për të bërë thurjen nga vrima në vrimë.

Demonstrohet procesi i thurjes së formës me tel dekorues duke bërë thurjen nga vrima në vrimë dhe në fund bëhet shturja e formës (e kthen formën në gjendjen e mëparshme). Pas demonstrimit dhe udhëzimeve, materiali u shpërndahet nxënësve dhe kërkohet që ta ndjekin të njëjtën procedurë të detyrës.







# FORMAT GJEOMETRIKE ME MATERIAL TË BUTË

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Material i butë (trolleks)
- Skallper


## REZULTATET

- Njih format gjeometrike
- Emërton drejt format gjeometrike

## MENYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Nxënësi udhëzohet që të ndajë materialin dhe të klasifikojë format gjeometrike sipas formave apo sipas ngjyrave. Përmes

prekjes me gisht në materialin bazë kërkojmë të identifikojë dhe emërtojë format gjeometrike. Merr një nga një përmbajtët e formave gjeometrike dhe i bashkon me format e zbrazëta të cilat gjenden në materialin bazë. njëjtën procedurë të detyrës.



# BASHKIMI I FOTOS ME OBJEKT DHE ME FJALË

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Fotografi me figura të pemëve
- Fletë plastifikuese
- Pemë nga plastika
- Fjalë që emërtojnë pemët

## REZULTATET

- Emërton pemët
- Lexon fjalën
- Bashkon fotografinë me objektin e njëjtë
- Bashkon fjalën me fotografinë dhe objektin e njëjtë

## MENYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Pemët në formë plastike emërtohen nga nxënësi, pastaj kërkohet që të bëjë bashkimin e tyre me pemët identike të plastifikuara. Për nxënësit që dinë të

lexojnë kërkohet që t'i bashkojnë foton me objektin dhe fjalën.

Ky aktivitet realizohet me hapa varësisht nga aftësitë e nxënësit p.sh merren dy pemë prej plastike, banane dhe rrush dhe fotografinë e bananes të plastifikuar, në mënyre që nxënësi të bëjë bashkimin e objektit me foton. Ky proces vazhdon duke shtuar foto, objekte dhe fjalë sipas objektivave mësimore të nxënësve.





# FORMIMI I FORMAVE TË NDRYSHME ME RRUAZA

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- Rruaza me ngjyra

## REZULTATET

- Formon format gjeometrike
- Njeh format gjeometrike
- Koordinimi sy - duar
- Zhvillon motoriken fine

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Materialin e vendosim përball

nxënësit. Kërkojmë nga nxënësi emërtimin e formave gjeometrike. Me anë të prekjes të përcaktojnë dhe të numërojnë këndet e secilës formë. Kështu plotësohen format veç e veç me rruaza të madhësive të ndryshme.



# KUTIA ME FORMA

## REZULTATET

- Njeh format
- Dallon ngjyrat
- Emërton format dhe ngjyrat

## NDËRTIMI

Marrim kutinë nga kartoni dhe e mbeshtjellim me letër ngjitëse me ngjyrë. Shenjëzojmë dhe hapim vendin e vrimave. Vizatojmë dhe prejmë forma të ndryshme në letër me ngjyra të cilat i ngjesim me ngjitës. Pastaj vizatojmë format e njëjta në fleta me ngjyrë, i

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Kuti nga kartoni
- Letër me ngjyrë
- Letër ngjitëse me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- Gërshërë
- Ngjitës

plastifikojmë dhe i prejmë me gërshërë.

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Fillimisht nxënësi njihet me materialin e përgatitur. Nxënësi duhet t'a seleksionojë materialin bazuar në forma dhe ngjyra. Udhëzohet që ato të vendosen në vrimat pranë formave të njëjta. Kështu vazhdohet deri të vendosen të gjitha format në kuti.





# ENA ME MIELL MISRI

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Fletë me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- Enë nga plastika
- Miell misri
- Brushë për ngjyrosje

## REZULTATET

- Njeh numrat 1-20
- Lexon numrat
- Rrit koncentrimin
- Ndihmon koordinimin sy-duar


## NDËRTIMI:

Marrim një fletë A4 dhe mbi të vendosim numrat nga 1-20 me ngjitës në mënyrë të çrregullt. Këtë fletë e plastifikojmë dhe me ngjitës e vendosim në fundin e enës nga plastika. Në të hudhim miell misri që të mbulohet e gjithë sipërfaqja. Brusha

shërben për zbulimin e secilit numër.

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT:

Nxënësit njoftohen për ecurinë e ushtrimit. Ata fillojnë që me anë të brushës të zbulojnë numrat dhe t'i lexojnë ata. Kështu vazhdohet me ushtrimin deri në përfundimin e tij. Kjo formë e punës mund të përdoret edhe në tema-lëndë tjera mësimore.





# LIDHJA E FOTOVE ME FJALË

## REZULTATET

- Njeh dhe emërton fotografitë
- Lexon fjalën drejt
- Lidhë fjalën me fotografi

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Vendoset materiali mbi bankë në mënyrë

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër e bardhë
- Gërshërë
- Fletë plastifikuese

të çrregullt. Nxënësi bën ndarjen e materialit duke i ndarë fotografitë nga fjalët. Pas kësaj fillon leximi i fjalëve dhe e shoqëron me fotografinë përkatëse. Varësisht nga nevojat e nxënësit ky material mund të përdoret edhe në forma të ndryshme.





# PASTRIMI I DUARVE

## REZULTATET

- Përcjell udhëzimet në fotografi
- Lëviz duart sipas udhëzimeve
- Bashkon fotografitë e njëjta

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Fleta A3 me fotot model të pastrimit të duarve vendoset para nxënësit. Nxënësit

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër e bardhë
- Fotografi me duar
- Fletë plastifikuese
- Hamer
- Velcro
- Gërshërë

i kërkohet të bëjë bashkimin e fotove të njëjta, pastaj të bëjë lëvizjen e duarve sipas fotove me radhë. Shablloni i pastrimit të duarve ngjitet para kronit në mënyre që nxënësi të praktikojë hapat sipas fotografive.



# SHKOPINJTË ME NGJYRA

## REZULTATET

- Njeh ngjyrat
- Zhvillon motoriken fine
- Zhvillon koordinimin sy-dorë
- Identifikon pozicionin e njëjtë

## NDËRTIMI

Marrim një letër të bardhë dhe e prejmë në pjesë të barabarta për të formuar karta. Shkopinj të vizatojmë në këto karta me ngjyra dhe në pozicione të ndryshme, pastaj i plastifikojmë. Kartat mund t'i bëjmë me numër të ndryshëm të shkopinjve, varësisht nga


## MATERIALI I NEVOJSHËM:

- Letër e bardhë
- Marker
- Shkopinj me ngjyra
- Fletë plastifikuese

njohuritë e nxënësve.

## PËRDORIMI I MATERIALIT

Përzgjedhim kartat që përmbajnë më pak shkopinj të vizatuar në forma të çrregullta dhe kërkojmë nga nxënësi t'i vendos mbi kartë shkopinj të njëjtë sipas ngjyrës dhe pozicionit. Mënyrë tjetër e përdorimit në punën me nxënës është formimi i formave të njëjta me shkopinj në një letër të bardhë duke shikuar kartën model e cila vendoset para nxënësit.







# LOJA ME LIDHËSA

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- Gërshërë
- Lidhëse


## REZULTATET

- Rrit përqendrimin
- Koordinimi sy – duar
- Zhvillon motoriken fine

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Mësuesja demonstroi aktivitetin.

Nxënësit i kërkohet që të kalojnë lidhësen nëpër vrima në drejtime të ndryshme. Ky aktivitet mund të zhvillohet me një apo dy nxënës edhe si lloj gare. Varëshitet nga potenciali psiko-fizik i nxënësit, mësuesja i jep shtytje fizike ose vetëm verbale.



# LOJA ME PULLA

## REZULTATI

- Njeh konceptet themelore (brenda, jashtë, e madhe, e vogël, e gjatë, e shkurtë)
- Emërton ngjyrat
- Zhvillon motoriken fine
- Rrit kohën e koncentrimin

## NDËRTIMI

Marrim dy kanaqe chipsi, i mbështjellim me letër me ngjyrë e të plastifikuar. Velcro ngjitet në formën e rrumbullakët në kanaqet e mbështjellura dhe në pulla.

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Kanaqet e mbështjellura vendosen para

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- Kanaqe chips-i
- Ngjitës
- Pulla me ngjyrë me madhësi të ndryshme
- Velcro
- Gërshërë

nxënësit dhe nga ai kërkohet të dallojë gjatësinë e tyre. Pullat me madhësi të ndryshme vendosen afër kanaqeve. Nxënësi udhëzohet që t'i vendosë pullat brenda, jashtë, në të shkurtën apo në të gjatën. Me këtë material nxënësit mund t'i kërkohet të bëjë klasifikimin sipas ngjyrave dhe madhësisë së pullave. Nxënësit që ende nuk kanë mësuar konceptet e lartpërmendura mund të përdorin këtë material si formë loje duke ngjitur dhe hequr pullat nga kanaqet.





# MBËRTHIMI DHE ZBËRTHIMI I PULLAVE

## REZULTATET

- Mbërthen dhe zbërthen pullat
- Koordinimi sy-dorë
- Zhvillon motoriken fine

## NDËRTIMI

Ndërtojmë një kornizë prej druri të madhësisë 20cm x 20cm. Prejmë materialin në madhësinë e kornizës së drurit në dy pjesë të barabarta. Në njëren pjesë hapim katër vrima, ndërsa në pjesën tjetër i qepim katër pulla. Materiali ngjitet në dy pjesët anësore të kornizës me thumba, ndërsa pjesa e vrimave dhe e pullave mbetet në mes.

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Kornizë druri 20cm x 20cm
- Material i pambukut
- Pulla
- Thumba

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Ky material kategorizohet në fushën për zhvillimin e aftësive të jetës së përditshme. Mësimi i shkathtësisë së mbërthimit dhe zbërthimit të pullave bëhet duke e ndarë aftësinë në hapa të vegjël, varësisht prej vlerësimit paraprak që i bëhet nxënësit për të testuar nivelin e njohurive për këtë aktivitet. Hapat shkruhen dhe mësohen sipas procedurës që kërkon përvetësimi i kësaj shkathtësie. I njëjti aktivitet mund të përdoret edhe me mbërthimin dhe zbërthimin e patentës (zingjirit të rrobave).



# TRUPI IM

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër e bardhë
- Fletë plastifikuese
- Foto të printuar
- Gërshërë


## REZULTATET

- Njih pjesët e trupit
- Lexon fjalë
- Nxitë komunikimin verbal

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Diskutojmë me nxënës rreth pjesëve të

trupit të njeriut. I njoftojmë me materialin e përgatitur dhe i udhëzojmë për mënyrën e punës së aktivitetit. Nxënësi merr tiketat me emrat e pjesëve të trupit, i lexon me radhë dhe vendos secilën tiketë në vendin e duhur në shabllon.







# AKULLORE ME NUMRA

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër me ngjyrë
- Letër e bardhë
- Fletë plastifikuese
- Velcro
- Gërshërë


## REZULTATET

- Njeh numrat nga 0-10
- Saktëson sasinë e numrit

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Me nxënësit diskutohet për gjërat që

blejmë, në këtë rast për akulloret dhe nxiten të mendojnë sa topa duan t'i marrin. Pas diskutimit nxënësi identifikon numrin e vendosur në pjesën e korntetit të akullores, pastaj sipas numrit të vendos topat që përdoren si elemente. Nxënësi vendos elementet sipas radhës, pra nga numri 1 - 6 apo edhe në mënyra tjera.



# PJESËT E LULES

## REZULTATET

- Njih pjesët e lules
- Emërton pjesët e lules

## NDËRTIMI

Marrim një letër A3 më ngjyrë, vizatojmë lulen në saksin dhe pjesët e saj dhe e plastifikojmë. Në letër me ngjyra vizatojmë petalet, kërcellin, gjethet, kurorën dhe saksinë e lules dhe shkruajmë emertimet e pjesëve të lules. Të gjitha këto i plastifikojmë, i prejme me gërshërë dhe prapa secilës pjesë vendosim copëza të

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- Marker
- Velcro
- Gërshërë

velcros, për t'i ngjitur në shabllonin e lules. Gjithashtu velcron e vendosim edhe në pjesët e lules së vizatuar në shabllon.

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Pasiqë ju prezantojmë nxënësve materialin e përgatitur, i pyesim për pjesët e lules. Nga ata kërkohet që këto pjesë t'i emërtojnë dhe t'i vendosin me radhë duke filluar nga rrënja.





# DHËMBË TË SHËNDOSHË

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- Velcro
- Fotografi
- Gërshërë

## REZULTATET

- Njih llojet e ushqimeve
- Dallon dhe klasifikon ushqimet e shëndetshme dhe jo të shëndetshme për dhëmbët
- Vendos tiketat me fotografi në vendin e duhur

## MËNYRA E P ËRDORIMIT TË MATERIALIT

Diskutohet me nxënës për higjienën

orale. Pyesim nxënësit për ushqimet e shëndetshme dhe jo të shëndetshme për dhëmbët. Para nxënësve vendoset materiali dhe jipen udhëzimet nga mësuesja se ku do të bëhet vendosja e ushqimeve të shëndetshme dhe jo të shëndetshme për dhëmbët. Nga nxënësit kërkohet që të emërtojnë fotografitë me ushqime dhe të bëjnë klasifikimin e tyre nëpër vendet përkatëse.



# LIBRI ME NUMRA DHE ELEMENTE

## REZULTATET

- Njeh format e numrave
- Mëson numrat përmes elementeve
- Njeh numrat
- Emërton numrat

## NDËRTIMI

Marrim 10 fleta të bardha karton A4. Në pjesën e sipërme të fletëve shkruajmë numrat rendor nga 1 deri në 10 dhe elementet përkatëse, pastaj fletët plastifikohen. Në pjesën e poshtme të




## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër me ngjyrë të bardhe A/4
- Fletë plastifikuese
- Lidhëse elastike
- Numra gome
- Pulla me ngjyra të ndryshme
- Shpuese letre
- Marker
- Velcro

faqes vendosim numrat rendor nga materiali i gomës dhe elementet me kopsa. Numrat dhe elementet ngjiten me velcro. Në fund libri shpohet dhe lidhet me lidhëse elastike.

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Numrat rendor në pjesën e sipërme përdoren për mësimin e konceptit të numrit duke i kërkuar nxënësit të numërojnë elementet për numrin përkatës dhe anasjelltas. Numrat dhe elementet në pjesën e poshtme të faqes zhvendosen nga velcro në mënyrë që nxënësi t'i vendos elementet në bazë të numrit dhe të identifikojë formën e numrit me anë të prekjes. Ky material didaktik mund të përdoret edhe me nxënësit me komunikim alternativ, me nxënës me dëmtime të rënda intelektuale dhe me nxënës me dëmtime në të parë.







# FORMAT GJEOMETRIKE

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- Gërshërë


## REZULTATET

- Njeh format gjeometrike
- Dallon format gjeometrike

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Nxënësit mësojnë emrat e formave dhe

karakteristikat e tyre pastaj i emërtojnë dhe i bashkojnë në sipërfaqen bazë të formave. Ata po ashtu mësojnë të dallojnë format e ndryshme që janë të paraqitura në aktivitet.



# LEXIMI ME SHIRIT RRËSHQITËS (TITËR)

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër me ngjyra
- Fletë plastifikuese
- Gërshërë
- Marker

## REZULTATET

- Lexon shkronjat
- Lexon rrokjet
- Lexon fjalët dhe fjalitë

## NDËRTIMI

Përzgjidhen fjalitë, shkruhen, printohen, plastifikohen dhe prehen në formë shiriti. Një fletë tjetër me ngjyrë plastifikohet dhe prehet si shirit më i gjërë dhe në fillim të shiritit hapet një vijë vertikale për kalim të fjalive të shkruara

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Mësuesja mban materialin në duar dhe kërkon nga nxënësi që të lexojë shkronjë për shkronjë, me rrokje apo me fjalë të plota duke rrëshqitur shiritin me fjali nga shiriti i zbrazët (shiriti me ngjyrë të gjelbër).





# PLOTËSIMI I FJALËS

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Fletë plastifikuese
- Fletë e bardhë
- Velcro
- Gërshërë

## REZULTATET

- Emërton shkronjat
- Lexon në rrokje
- Lexon fjalën e plotë

në fjalë. Vendoset velcro në hapësirën ku mungon shkronja dhe në shkronjat e ndara.

## NDËRTIMI

Printohen dhe plastifikohen fjalët me një apo dy shkronja të munguara, si dhe plastifikohen edhe shkronjat që mungojnë

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Para nxënësit vendoset fjala dhe shkronjat e ndara dhe kërkohet nga ai-ajo të gjejë shkronjën përkatëse. Emërtohen një nga një shkronjat, lexon rrokjet pastaj fjalën e plote.



# MOLLËKUQJA

## REZULTATET

- Rrit koncentrimin
- Shqipton drejt rrokjen
- Zhvillon memorien

## NDËRTIMI


Fillimisht marrim një letër të kuqe në të cilën me dorë të lirë vizatojmë një mollëkuqe. Brenda mollëkuqes vizatojmë disa rrrathë në letër me ngjyrë të bardhë dhe shkruajmë rrokjet. Të njëjtat rrokje plastifikohen dhe prehen në rrrathë të njëjtë të mollëkuqes. Marrim një letër me ngjyrë të zezë, e plastifikojmë dhe e presim në rrrathë të vegjël për t'i shfrytëzuar pastaj si kapak për mbulimin e rrokjeve të shënuara në mollëkuqe.

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letra të bardha
- Laps
- Gomë
- Marker
- Ngjyra të drurit
- Fletë plastifikuese
- Gërshërë

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Mollëkuqja e mbuluar me rrrathë të zinj i vendoset nxënësit në bankë, ndërsa rrokjet tjera vendosën pranë saj. Nxënësi përzgjedh një rrokje, lexon dhe shqipton drejt dhe fillon të kërkojë rrokjen përkatëse duke zbuluar rrrathët e zinj derisa ta gjejë rrokjen që mban në dorë (rrrethi i zi i rrokjes së zbuluar kthehet përsëri në vend nëse nuk është e njëjta). Aktiviteti vazhdohet deri në zbulimin e të gjitha rrokjeve.





# ORA

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër me ngjyrë
- Ora e printuar
- Fletë plastifikuese
- Kapse rrobash
- Gërshërë
- Marker

## REZULTATET


- Njeh orën e plotë
- Lëviz akrepat në kahjen e duhur

## NDËRTIMI

Në një letër me ngjyrë printojmë orën (ora e printuar përfshin orën e plotë, minutat, sekondat të grafikuara me vija dhe numra). Pastaj ora e printuar plastifikohet, prehet për ta marrë formën e orës dhe i ngjiten akrepat, të cilët punohen nga materiali plastifikues. Kapseve ju shënohen numrat e orës së plotë.

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Vendoset ora para nxënësit, mësuesja lëviz akrepat e orës duke demonstruar kahjen e lëvizjes së akrepave. Kërkohe nga nxënësi që të vendos kapsen e rrobave me numër në vendin e caktimit të orës së plotë ku mësuesja ka vendos akrepin. Ky proces përsëritet disa herë derisa nxënësi të përvetësojë mirë, pastaj kërkohe nga nxënësi që të bëjë vetë lëvizjen e akrepave dhe të vendos numrin adekuat.





# NUMRAT ME NGJYRA

## REZULTATET

- Njeh numrat
- Rrit koncentrimin
- Njeh ngjyrat

## NDËRTIMI

Në fleta të bardha formohet numri me rrrathët e prerë në madhësinë e kapakëve të shisheve të cilët ngjiten në fletën e bardhë dhe plastifikohen.


## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Numrat e formuar nga 1 deri në

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër e bardhë
- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- Kapak të shisheve me ngjyrë
- Ngjitës
- Gërshtë

10 mund të vendosen në mënyrë të rregullt mbi bankë, në mënyrë të çrregullt, numrat çift apo tek. Nga nxënësi kërkohet të marr njërin nga numrat p.sh. numrin 1 ta vendos afër vetës, pastaj nxënësi udhëzohet që të marrë kapakët sipas ngjyrës së njëjtë me ngjyrën e rrrathëve me të cilët është formuar numri dhe t'i vendosë secilën mbi rrethin me ngjyrë përkatëse. E njëjta procedurë vazhdon dhe me numrat e tjerë deri në numrin 10.





# KAFSHËT SHTEPIAKE DHE TË EGRA

## REZULTATET

- Njeh kafshët
- Dallon kafshët shtëpiake dhe të egra
- Njeh karakteristikat e kafshëve shtëpiake dhe të egra
- Klasifikon kafshët
- Lidhë fjalën me fotografinë përkatëse

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Fillimisht nxënësi emërton kafshët të cilat i paraqiten përmes fotografive. Bashkërisht përmes pyetjeve dhe

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Fotografi të printuara me kafshë
- Emërtime të kafshëve të printuara
- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- Velcro
- Gërshërë

përgjigjeve diskutohet për karakteristikat e secilës kafshë, me fokus të veçantë duke bërë ndarjen e kafshëve të egra nga ato shtëpiake. Nëse nxënësi lexon i kërkohet të bëjë lidhjen e fjalëve me fotografi, në rast se nxënësi nuk lexon atëherë atij i kërkohet të bëjë klasifikimin e kafshëve dhe t'i vendos një nga një në shabllone përkatëse. Mënyra e njëjtë e aktivitetit mund të përdoret dhe me shumë kategori të tjera si p.sh. me shpezë, me profesione, me mjete të punës etj.



# TIKETA ME FJALË DHE FJALI

## REZULTATET

- Rendit fjalët sipas modelit
- Formon fjalinë me kuptim
- Lexon fjalinë e formuar

## NDËRTIMI


Përzgjedh fjalitë, printohen në fleta me ngjyrë dhe plastifikohen. Fjalitë e plastifikuara ndahen-prehen në fjalë. Sipas aftësisë dhe nevojës së nxënësit mund të printohet dhe plastifikohet edhe një shabllon i fjalive të njëjta që shërben për vetëkontroll të renditjes së drejtë të fjalëve në fjali.

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- Gërshërë

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Vendosen para nxënësit fjalët e ndara dhe kërkohet nga ai të formojë një fjali përkatëse, p.sh. Babi ka blerë shumë gjëra ushqimore. Para nxënësit fjalët vendosen në mënyrë të çrregullte dhe varësisht nga niveli i njohurive të nxënësit mund të shtojmë 2-3 fjalë që nuk lidhen me fjalinë përkatëse. Në fund nxënësi mund të përdorë shabllonin e vetëkorrigjimit.







# BASHKIMI I RROKJEVE

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- Gërshërë

## REZULTATET

- Lexon ne rrokje
- Krijon fjalë me kuptim
- Rendit fjalët sipas modelit

## NDËRTIMI

Përzgjidhen fjalët, printohen në fleta me ngjyra të ndryshme, bëhen tri kopje te njëta dhe plastifikohen. Njëri shabllon mbetet me fjale te plota, i dyti mbetet me fjale te ndara ne rrokje kurse i treti prehen ne tiketa.

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Kërkohet nga nxënësi të lexoi rrokjet ne tiketa për të përforcuar leximin. Përzgjedhim tri rrokje p.sh DO,RA, BU dhe kërkohet nga nxënësi të formoj fjalën DO-RA. Për të parë rezultatit nxënësit i jepet shablloni i vetëkorgjimit. Dhekështu vazhdohetmeradhe. Varësisht nga njohja e nxënësit me llojin e shkronjave materiali mund të bëhet me shkronja të mëdha , të vogla apo të kombinuara.



# KLASIFIKIMI I EMRAVE

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- Gërshërë

## REZULTATET

- Dallon emrat e përveçëm dhe të përgjithshëm
- Klasifikon emrat e përveçëm dhe të përgjithshëm
- Lexon

ndarja të bëhet sipas kategorisë përkatëse dhe jo ngjyrave.

## NDËRTIMI

Përzgjidhen emrat, printohen në letër me ngjyrë dhe plastifikohen. Emrat e plastifikuar prehen secili veç e veç. Në fletë me dy ngjyra të ndryshme plastifikohen tiketat Emrat e përgjithshëm dhe Emrat e përveçëm. Emrat e plastifikuar duhet të jenë me ngjyra të ndryshme në mënyrë që

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Pasi nxënësi të ketë mësuar veçoritë e emrit të përgjithshëm dhe të përveçëm vendosen para tij tiketat me emra të përzier (të përgjithshëm dhe të përveçëm). Nxënësi udhëzohet që t'i lexojë emrat dhe t'i ndajë në shtyllë sipas kategorisë së kërkuar.





# TABELA ME FUSHA

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Hamer
- Marker
- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- Gërshërë

## REZULTATET

- Lexon fjalë
- Kupton fjalët e lexuara
- Vendos fjalët në këndin e caktuar
- Respekton rregullat në grup


me ngjyra, printohen, plastifikohen dhe prehen në formë të tiketave.

## NDËRTIMI

Mbi hamer vizatohen vija për të formuar fusha dhe ato emërtohen sipas temës së caktuar p.sh tema Qyteti im dhe në lidhje me këtë përzgjedhen pjesë të temës me të cilat emërtohen fushat. Në proporcion me emërtimin e fushave përzgjedhim fjalët e caktuara, të cilat shkruhen në fletë

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Fillimisht bisedohet me nxënësit për temën e caktuar. Vendoset materiali para nxënësve në hamer me fushat e emërtuara dhe përreth tij vendosen tiketat me fjalë. Kështu udhëzohen nxënësit që me radhë të tërheqin nga një tiketë, ta lexojnë para grupit pastaj ta vendosin në fushën që i përgjigjet.



# TREGIMI ME TIKETA

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Fotografi me tregime
- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikues
- Gërshërë
- Velcro

## REZULTATET

- Zhvillon komunikimin
- Pasuron fjalorin
- Kupton ngjarjen
- Radhit tiketat sipas ngjarjes
- Dallon personazhet pozitive dhe negative

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Komentohet tregimi nga mësuesja,

shtrojmë pyetje dhe presim përgjigje nga nxënësit. Materiali me fotografi vendoset përpara nxënësit dhe udhëzohet të komentojë secilën tiketë të tregimit me radhë pastaj t'i radhis sipas zhvillimit të ngjarjes.





# BASHKIMI I RROKJEVE ME PENJ

## REZULTATET

- Lexon me rrokje
- Krijon fjalë
- Zhvillon motorikën fine
- Vetëkorrigjon

## NDËRTIMI

Vizatohet një figure p.sh. figura e krimbit. Në anën e majtë dhe të djathtë të figurës shkruhen rrokjet në mënyrën vertikale. Rrokjet shkruhen në mënyrë të tërthortë. Mbrapa figurës vizatohen vijat të cilat do të jenë çelësi i rezultatit. Plastifikohet fleta dhe prehet në mënyrë harmonike (një rrokje në një hark). Tek pjesa e sipërme e

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- Marker
- Penj
- Gërshërë

figurës shpohet një vrimë dhe lidhet një pe.

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Mësuesja tregon fjalë të cilat formohen me rrokjet e shkruara ne figure. Materiali i ofrohet nxënësit dhe udhëzohet që perin fillimisht ta vendos tek rrokja ne anën e majtë, pastaj të bashkojë me rrokjen në anën e djathtë dhe të formojë fjalën e plotë. Kështu i përcjell të gjitha rrokjet dhe në fund e shikon anën mbrapa materialit a janë përshkuar të gjitha vijat drejt me pe e cila shërben për vetëkorrigjim. Nëse po atëherë zgjidhja është e saktë.





# DITËT E JAVËS

## REZULTATET

- Emërton ngjyrat
- Bashkon ngjyrat e njëjta
- Emërton ditët e javës
- Mëson ditët e javës sipas ngjyrave ndërkombëtare
- Orientohet në kohë

## NDËRTIMI

Në hamer vizatohen hapësira te cilat ngjyrosen dhe shkruhen ditët e javës. Hapësirat ngjyrosen sipas ngjyrave ndërkombëtare te cilat përcaktojnë ditët e javës (p.sh e hënë me ngjyrë të gjelbër, e marte me ngjyrë të kaltër, e mërkurë me ngjyrë të bardhë, e enjte më ngjyrë kafe, e premte më ngjyrë të verdhë, e shtunë më ngjyrë roze dhe e dielë me ngjyrë të kuqe). Në secilën hapësirë vendoset edhe kordoni ngjitës - velcro. Në fleta me ngjyra shkruhen ditët e javës - gjithnjë sipas përcaktimit që u theksua me lartë, printohen, plastifikohen dhe pastaj prehen në forme të tiketave. Secilës tiketë në anën e prapme i vendoset kordoni ngjitës - velcro.


## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Kalendari bazë

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Hamer
- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- Laps
- Marker
- Ngjyra
- Gërshërë
- Velcro

vendoset në murin e klasës në lartësinë e përshtatshme për përdorim nga nxënësit. Nga nxënësi kërkohet që të emërtojë ditët e javës, pastaj t'i marrë tiketat dhe t'i vendosë në hapësirat e fletës së madhe, gjithnjë duke i përputhur tiketën me hapësirën (emërtimin dhe ngjyrën). Për t'u kuptuar logjikisht ditët e javës nga nxënësi çdo ditë kërkohet të na tregojë ditën duke i'u referuar ngjyrave. Po ashtu kërkohet të na tregojë se çfarë dite është sot, cila dite ishte dje dhe çfarë dite është nesër.





# DJE, SOT, NESËR

## RZULTATET

- Njih ditët e javës
- Kupton konceptin kohor (dje, sot, nesër)
- Rendit ditët sipas konceptit kohor dje, sot, nesër

## NDËRTIMI

Shkruhen ditët e javës dhe konceptet kohore. Printohen tri kopje në letra me ngjyra me ditët e javës, kopja baze me ngjyre të bardh, dy tjerat me ngjyrë të verdhe dhe një kopje me koncepte kohore. Plastifikohen 2 kopje me ditët e javës me ngjyre të verdhë dhe prehen me gërshërë. Në fletën A3 vizatojmë me marker hapësirat ku do të vendosen ditët e javës dhe konceptet kohore. Lartë fletës vendosen konceptet kohore dhe në mes të kësaj flete vendosim ditët e javës në mënyrë të përditshme, pastaj këtë fletë e plastifikojmë. Mbi fletën A3 të plastifikuar vendosim velcron në hapsirat e vizatuara.

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- Gërshërë
- Velcro

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Nga nxënësit kërkohet të lexojnë ditët e javës dhe t'i vendosin në bazë të udhëzimit të kërkuar. Gjatë vendosjes bëhet bashkëbisedim me nxënësin nëse është e nevojshme duke bërë pyetje të shkurta për ta ndihmuar nxënësin të dallojë dje, sot dhe nesër. Ky ushtrim mund të përdoret edhe në gjuhën shqipe.



# STINËT DHE MUAJT

## REZULTATET

- Njeh stinët e vitit
- Emërton muajt dhe stinët
- Dallon muajt e vitit
- Klasifikon muajt sipas kërkesës
- Orientohet në kohë

## NDËRTIMI

Bëhet përzgjedhja e fotografive me peizazhe të stinëve të vitit dhe i printojmë me ngjyrë. Në një fletë tjetër me ngjyrë shkruajmë muajt e vitit dhe i printojmë. Prapa stinëve dhe muajve ngjesim nga një rreth letre me ngjyra që simbolizojnë stinët e vitit (e gjelbër-pranvera, e kuqevera, e portokalltë-vjeshta dhe e bardhë-dimri). I tërë materiali plastifikohet dhe prehet me gërshërë në formën e kërkuar.

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Nxënësve u ofrohet materiali i përgatitur. Nga ata kërkohet të emërtojnë stinët e vitit dhe t'i rendisin ato sipas radhës që kanë. Po ashtu u kërkohet të shqiptojnë muajt e vitit. Që ta kenë më të lehtë detyrën,

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër e bardhë
- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- Gërshërë
- Ngjitës

nxënësve u rikujtohet që secila stinë ka nga tre muaj, andaj klasifikimi duhet të jetë i tillë. Udhëzohen që renditjen ta bëjnë nga muaji që fillon stina p. sh. pranvera fillon në muajin mars, andaj renditja fillon po nga ky muaj. E njëjta procedurë ndiqet edhe për stinët tjera. Bazuar në stinën përkatëse, nxënësit marrin tiketat e muajve të vitit dhe i vendosin ato pranë stinës që i takon. Pasi përfundon renditjen e muajve të vitit, nxënësi duhet të bëjë vetëkorrigjimin e detyrave duke i kthyer tiketat prapa dhe të shohë zgjidhjen e saktë sipas rrathëve me ngjyra, nëse përkojnë stinët me muajt.







# DORA TREGUESE

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër me ngjyra
- Figura që kanë të bëjnë më temën
- Fletë plastifikuese
- Velcro
- Gërshërë

## REZULTATET

- Komunikon me fotografi
- Njeh përemrat pyetës
- Precizon vendosjen e copëzave
- Vendos tiketat bazuar në figura

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Nxënësit njoftohen me titullin e shkruar në pëllëmbë të dorës dhe me temën që do të zhvillohet. Diskutojmë rreth përemrave pyetës të shënuar në thonjtë e gishtërinjve dhe përgjigjeve të mundshme lidhur me temën. Mund të përdorim përemra pyetës të ndryshëm, varësisht nga përmbajtja e

temës që zhvillohet. Në rastin tonë kemi marrë këta përemrat: Cila, Kur, Kush, Çfarë dhe Pse, meqë këta i përshtaten temës sonë (Viti i Ri) dhe tiketave të përgatitura. Nxënësit udhëzohen të përzgjedhin tiketat dhe t'i rendisin saktë ku kërkohet, bazuar në pyetjet e shtruara dhe në përgjigjet që ofrojnë fotografitë e plastifikuara, p.sh. me përemrin pyetës Çfarë formojmë pyetjen : Çfarë na sjell babadimri? Nxënësi zgjedh tiketën që i përgjigjet pyetjes (tiketën me dhurata) dhe me precizitet e vendosë në vendin e duhur. E njëjta procedurë ndiqet nëpër të gjitha pyetjet e shkruara paraprakisht.



# SHOQËRIMI I FJALËVE

## REZULTATET

- Lexon drejt
- Njeh emrat
- Njeh foljet
- Lidhë emrin me foljen
- Koncentrohet në përdorimin e materialit posedues

## NDËRTIMI

Në një fletë me ngjyrë tërheqim një tabelë me vija horizontale dhe vertikale me precizitetin e nevojshëm, bazuar në numrin e fjalëve që do përdorim. Në anën e majtë të asaj flete shkruajmë fjalë-emërtime të ndryshme (në rastin tonë kemi marrë disa emërtime të pjesëve të trupit), p.sh. syri, veshi,... Në hapësirën e fletës (që duhet të jetë e zbuluar) shënojmë veprimet e mundshme që kryhen nga ato emërtime, p.sh. shikon, dëgjon,... Në një fletë të bardhë vizatojmë një skemë tabelare duke shenjëzuar me nga një "X" në vendet e caktuara, të cilat duhet të hapen më pas me gërshërë. Fletën e parë e ngjesim mbi kanaqen e chips-ave. Mbi të vendoset fleta e bardhë me pjesët e hapura, duke lënë të zbuluar anën e majtë


## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Kanaqe chips-i
- Letër me ngjyrë
- Marker
- Ngjitës letre
- Gërshërë

ku shkruhen fjalët e caktuara. Të dy fletët marrin formë cilindrike (të kanaqes).

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Nxënësit njihen me fjalët e shkruara në anën e majtë të fletës – emrat dhe me ato brenda saj – foljet. Më pas udhëzohen që me dorën e majtë të mbajnë kanaqen e chips-it, ndërsa me të djathtën të rrotullojnë fletën e mbivendosur rreth saj, duke kërkuar-zbuluar zgjidhjen në pjesët e hapura. Nxënësit lexojnë këto fjalë dhe diskutojnë rreth zgjidhjes së drejtë të tyre. Në këtë mënyrë bëhet shoqërimi i emrave me foljet, p.sh. syri – shikon, veshi – dëgjon, gjuha-shijon, etj.





# LIDHJA E PËREMËRIT ME FOLJEN

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër me ngjyrë
- Figura të babadimrit
- Fletë plastifikuese
- Ngjitës letre
- Gërshërë


## REZULTATET

- Njeh përemrat vetor
- Njeh foljet në kohën e tashme
- Lidhë përemrin me foljen
- Klasifikon sipas kërkesës

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Nxënësit njoftohen me përemrat dhe foljet e shkruara në figurat e babadimrit. Më pas diskutojmë rreth zgjidhjes së drejtë të zgjedhimit të foljes duke e shoqëruar me përemrat e duhur. Nxënësit marrin tiketat e parentitura dhe udhëzohen t'i rendisin siç kërkohet (një rend me

përemra vetor dhe paralel me ata një rend me foljet adekuate), p.sh. krahas tiketës me përemrin vetor unë – vendoset tiketa me foljen lexoj. Vazhdohet kështu deri në përfundim të detyrës, e më pas vërtetojmë saktësinë e saj përmes vetëkorrigjimit-r Rathëve me ngjyra që i kanë të ngjitura tiketat prapa. Kanë të njëjtën rreth me ngjyrë si përemri ashtu dhe folja që i përshtatet, p.sh. përemri unë ka rreth të gjelbër, po ashtu edhe folja lexoj (që i përgjigjet drejtë) ka rreth të gjelbër. Ngjyrat e r Rathëve ndryshojnë varësisht nga ndryshimi i zgjedhimit të foljes.



# ORA KËRKON ORËN

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër me ngjyrë
- Foto të orës
- Fletë plastifikuese
- Ngjitës letre
- Gërshërë

## REZULTATET


- Njeh orën
- Orientohet në kohë
- Gjenë orën e saktë
- Rendit sipas kërkesës së tiketave

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Nxënësit njoftohen me llojet e orës me të cilat do të punojmë. Qartësojmë mënyrën e përdorimit të tiketave sipas kërkesës, për të arritur tek zgjidhja e saktë.

Nxënësit marrin tiketat e parenditura dhe udhëzohen t'i rendisin saktë siç kërkohet (njëra orë kërkon tjetrën sipas vendosjes së akrepave). Saktësinë e detyrave mund t'a vërtetojmë përmes vetëkorrigjimit të tiketave (numrave të shënuar prapa tiketave nga 1...).

Ky model pune mund të përshtatet në tema të ndryshme (me renditje të figurave dhe emërtimeve të ditëve, muajve, pemëve, perimeve, etj.).







# VJESHTA E ARTË

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër me peizazh vjeshte
- Ngjyra druri
- Fletë plastifikuese
- Velcro
- Gërshërë

## REZULTATET

- Dallon veçoritë e stinës
- Bashkon fotografitë e njëjta
- Precizon vendosjen e copëzave

## NDËRTIMI

Materiali përbëhet nga dy fletë të njëjta ku janë vizatuar veçoritë e vjeshtës. Këto fletë ngjyrosen me ngjyra që e specifikojnë këtë stinë dhe plastifikohen. Njëra mbetet e kompletuar dhe shërben si tabelë orientuese, ndërsa tjetra prehet me gërshërë në copëza-pjesë që duam t'i theksojmë më shumë, p.sh. pema me fruta, rrushi që vilet, fëmijët që mbledhin pemë e perime, etj. Këto copëza- pjesë duhet të ngjiten me kordonin ngjitës- velcro.

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Nxënësi njoftohet me materialin që do të zhvillojmë aktivitetin. Ai duhet të vëzhgojë me vëmendje pamjen që ka para vetes dhe nxitet të komentojë veprimet dhe veçoritë që sheh në peizazh. Pas kësaj udhëzohet që të gjejë copëzën identike dhe secilën ta vendosë mbi të njëjtën, mbi tabelën orientuese në mënyrë që të jepet imazhi i njëjtë. Duhet të dalë komplet pamja e njëjtë me tabelën orientuese-me fletën bazë.





# ALFABETI I GJUHËS ANGLEZE

## REZULTATET

- Njeh alfabetin e gjuhës angleze
- Bashkon shkronjat e njëjta

## NDËRTIMI

Marrim një letër A4 me ngjyrë, në të printojmë alfabetin e gjuhës angleze dhe e plastifikojmë. Mbledhim disa kapak të shisheve dhe mbi secilin shkruajmë me marker shkronjat me radhë. E njëjta vlen edhe për ushtrimin me ngjyrë të verdhë, vetëm se këtu bëhet printimi i dy shablloneve me ngjyra të ndryshme me alfabetin e gjuhës angleze. Nga njëri shabllon i prejme shkronjat një nga një,


## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- Kapak të shisheve
- Marker permanent
- Gërshërë

ndërsa tjetri mbetet si shabllon bazë.

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Materialet e përgatitura vendosen para nxënësve, duke i njoftuar ata për ecurinë e punës. Nga nxënësit kërkohet që të lexojnë secilën shkronjë në gjuhën angleze dhe të vendosin kapakun (ose në ushtrimin tjetër copëzën) mbi shkronjën e duhur. Ky aktivitet mund të përdoret edhe në lëndën e gjuhës shqipe dhe në matematikë duke ia përshtatur lëndës.





# LOJA ME NUMRA

## REZULTATET

- Njeh numrat 0-10
- Njeh sasinë e numrit
- Rritë koncentrimin

## NDËRTIMI

Marrim njëmbëdhjete rolne prej kartoni (letrat higjienike) dhe i mbështjellim me letër me ngjyrë si dhe shkopinj druri me ngjyra. Në rolne me marker shkruajmë numrat nga 0 deri në 10.

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Material reciklues rolne kartoni
- Marker
- Letër me ngjyrë
- Gërshërë
- Ngjitës letre
- Shkopinj të drurit me ngjyra

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Në bankë rendisim vertikalisht rolnet me numra. Nxënësit i kërkohe t'i identifikoj numrat, pastaj të vendos brenda rolnes aq shkopinj sa tregon numri dhe njëkohësisht përshtatjen e ngjyrave. Rolnet me numra mund të vendosen edhe në mënyrë të çrregullt.



# NUMRIMI ME ELEMENTE

## REZULTATET

- Njeh konceptin e numrit
- Zhvillon motoriken fine
- Rrit koncentrimin

## NDËRTIMI

Në letër të bardhë printojmë numrat, plastifikohen dhe prehen në formë të tikeleve të vogla dhe shpohen në skaje të numrit. Marrim tel dekorues me ngjyra e

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër e bardhë
- Fletë plastifikuese
- Numra të printuar
- Shpuese letre
- Tel dekorues
- Rruaza druri

lidhim me numrat e plastifikuar.

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Nxënësit i japim udhëzimet që të tërheqë një tel me numër dhe të shqiptojë numrin, pastaj i kërkohet që të fusë rruaza bazuar në numrin.





# FUSHA ME TOP PINGPONGU

## REZULTATET

- Njeh numrat
- Rrit koncentrimin
- Zhvillon motoriken

## NDËRTIMI

Material reciklues prej kartoni përdoret për të ndërtuar fushën e lojës me numra. Sipërfaqen kryesore e mbulojmë me letër të bardhë të plastifikuar, ndërsa anash përforcohet me ngjitës që në materialin konkret është përdorë ngjitës. Rolnet i mbështjellim me letër me ngjyra të ndryshme, mbi ta vendosim numrat dhe ngjiten në sipërfaqen e fushës së bardhë.

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Rolne prej kartoni (material reciklues)
- Top pingpongu
- Letër gome
- Letër e bardhë
- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- Ngjitës

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Loja me topa mund të zhvillohet në aktivitet njësh apo në aktivitet dysh. Loja zhvillohet duke stimuluar nxënësit që të shqiptojë numrat dhe të kalojnë topin nëpër rolne me numra sipas radhës. Për ta bërë lojën më nxitëse për nxënësin, mësimdhënësja mund të llogarisë kohëzgjatjen e kalimit të topit nëpër rolne. Nëse duam të zhvillojmë aktivitetin dysh preferohet të kemi dy materiale të tilla në mënyrë që nxënësit të zhvillojnë lojën në të njëjtën kohë.





# NUMRAT ME ELEMENTE

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër e bardhë
- Fletë plastifikuese
- Karton i zi
- Tel


## REZULTATET

- Njeh numrat
- Njeh sasinë e numrit

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Dy telat i vendosim në formë të rrethit

mbi bankë. Mësimdhënësja në pjesën e poshtme të rrethëve vendos nga një numër. Nxënësi udhëzohet që në bazë të numrit të merr aq elemente dhe t'i vendos brenda rrethëve.







# DOMINO ME FORMA

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- *Letër e bardhë*
- *Fletë plastifikuese*
- *Marker*


## REZULTATET

- *Njeh format gjeometrike*
- *Bashkon format e njëjta*
- *Njeh ngjyrat*

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Nxënësit emërtojnë dhe bashkojnë

format dhe ngjyrat sipas udhëzimit të mësueses. Aktiviteti fillon duke përzgjedhur numrin më të vogël të dominove derisa nxënësi të kuptojë procedurën. P. sh. tiketës së parë me tri forma dhe me ngjyrë të gjelbër i ofrohet tiketa me formë dhe ngjyrë të njëjtë.



# SEKRETET E BREDHIT

## REZULTATET

- Njeh numrat nga 1-20
- Njeh numrin sipas elementeve

## NDËRTIMI

Në një hamer me ngjyrë vizatojmë formën e bredhit. Prejmë bredhin e vizatuar me gërshërë. Në një hamer tjetër me ngjyrë të gjelbër i prejmë 20 kaltëror me madhësi të njëjtë. Katrorët duhen të jenë dy pjesësh në mënyrë që brenda hapësirës të vizatojmë elemente aq sa tregon numri i vendosur

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Hamer
- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- Laps
- Ngjyra
- Ngjitës
- Gërshërë

jashtë katrorit.

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Nxënësit i kërkohet që të shqiptojë numrin pastaj të hapë dritaren për të zbuluar elementet përkatës. Po ashtu nxënësit numërojnë dhe emërtojnë elementet që fshihen pas numrit derisa të zbulohen sekretet e bredhit.





# MOLLËKUQJA ME NUMRA

## REZULTATET

- Njeh numrat çift
- Dallon gjysmën e numrit
- Mbledhë dhe zbret numrat

## NDËRTIMI

Marrim letër me ngjyrë dhe i vizatojmë dhjetë forma të rrathëve duke përdorur një CD dhe lapsin. Vizatojmë kokat e mollëkuqeve dhe i vendosim pranë secilit rreth duke ngjitur me ngjites një rreth me tjetrën. Me anë të markerit shkruajmë numrat çift mbi secilën mollëkuqe. Në një hamer tjetër vizatojmë prap dhjetë rrethë me CD dhe i prejme me gërshërë në dy pjesë të barabarta. Mbi secilën pjesë vendosim gjysmën e pikave që kur të


## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- CD
- Laps
- Velcro
- Gërshërë
- Marker

bashkohen mes veti na japin numrin në mollëkuqe.

## MËNYRA E P ËRDORIMIT TË MATERIALIT

Nxënësi merr bazën e mollëkqes dhe i kërkohet që të tregojë numrin. Varësisht nga rezultati e të nxënës zbulojmë aktivitetin, p.sh. nëse kemi rezultatin e kuptimit të gjysmës së numrit, mësimdhënësja vendosë njërin krah të mollëkuqes në bazën e mollëkuqes dhe nga nxënësi kërkohet që të gjejë krahun tjetër me elemente që plotësojnë numrin.



# TABELA ME NUMRA

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- Gërshërë


## REZULTATET

- Njeh numrat 1-100
- Identifikon numrin
- Bashkon numrat e njëjtë
- Rendit numra te njëjtë

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT:

Nxënësit punojnë me tiketa ku janë të

shënuar numrat nga 1 deri 100. Tiketat shpërndahen në bankë. Meqë tabela bazë ka numrat nga 1 deri 100, nxënësit udhëzohen që copëzat e prera në forma të ndryshme t'i mbivendosim në sipërfaqen e tabelës.







# AKREPAT E ORËS

## REZULTATET

- Njeh orën e plotë
- Njeh minutat e orës
- Dallon orën e plotë nga minutat
- Përdorë orën për orientim kohor

## NDËRTIMI

Në një letër të bardhë shkruajmë orën e plotë, e plastifikojmë dhe e prejmë me gërshtë pjesën e numrave anash. Marrim një letër A4 me ngjyrë, i shkruajmë minutat me marker, e plastifikojmë dhe e prejmë me gërshtë në formën e orës. Letrën me orën e plotë e ngjeshim mbi fletën me ngjyrë. Mbi hapësirën e orës vendosim në mes akrepat me një thumb, të cilët paraprakisht i vizatojmë, i prejmë në një letër me ngjyrë dhe i plastifikojmë. Afër secilit numër që tregon orën

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër me ngjyrë
- Letër e bardhë
- Fletë plastifikuese
- Letër gome
- Ngjitës
- Gërshtë
- Thumb
- Marker

vendosim nga një copëz gome te prerë në formë ylli.

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Nxënësit fillimisht njoftohen me pjesët e orës si numrat, orën e plotë, minutat, akrepat, pastaj diskutojmë për funksionin e secilës pjesë të orës. Gjatë procesit të diskutimit nxënësit mëson orën e plotë, pastaj i këkohet të lëviz akrepat e orës, të hapë pjesën në formë të dritarës dhe të zbulohen minutat. Me praktikimin e këtij aktiviteti vazhdohet deri në mësimin e orientimit kohor.





# PARAARDHËSI DHE PASARDHËSI I NUMRAVE

## REZULTATET

- Njeh numrat nga 1-30
- Rendit numrat
- Gjen paraardhësin dhe pasardhësin e numrit


## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Materiali i përgatitur vendoset para

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër e bardhë
- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- Numra të punuar me kompjuter
- Gërshërë
- Velcro

nxënësve. Diskutojmë lidhur me radhën e numrave, paraardhësin dhe pasardhësin e tyre. Ata udhëzohen që numri i cili kërkohet të vendoset në vendin e duhur në tabelë.





# SHOQËRIMI I NUMRAVE ME FJOLLA BORE

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Fletë e bardhë me ngjës
- Tapetë ngjitesë
- Gërshërë
- Pllaka të drurit (llaminat)

## REZULTATET

- Bashkon numrin me elemente
- Identifikon elementet


## NDËRTIMI

Printohen fletat me numra dhe fotot me elemente në fletë A4 me ngjës, pastaj mbi fletën A4 me numra dhe elemente ngjesim tapetën ngjitesë për ruajtjen më të gjatë të materialit. Secilin numër dhe secilin element e prejme me gërshërë, me madhësi sa janë pllakëzat prej druri ku

do të vendosen numrat dhe elementet. Materialit të prerë i heqim prapa letrën ngjitesë dhe i ngjesim nëpër pllakëza.

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Para nxënësve vendosen pllakëzat me numra dhe elemente. Diskutojmë me nxënësit për numrat nga 1-10. Udhëzohen që ti radhisin numrat dhe t'i gjejnë elementet përkatëse të secilit numër.



# DOMINO – MBLEDHJE

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër e bardhë me ngjitës
- Gërshërë
- Pllaka të drurit
- Tapete ngjitëse

## REZULTATET


- Mbledh numrat me elemente
- Rendit dominot sipas rezultateve

## NDËRTIMI

Printohet fleta me ngjitës ku kemi shkruar detyra me mbledhje duke i shoqëruar me elemente, pastaj vendoset tapeta ngjitëse. Pllakëzat dhe fletat ngjitëse prehen me madhësi të njëjtë, pastaj fletën ngjitëse e ngjesimë mbi pllakëzen e drurit.

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Nxënësit njoftohen me materialin me te cilin do ta zhvillojmë aktivitetin. Pllakëzat vendosen në mënyre të çrregullte dhe udhëzohen nxënësit që ato t'i radhisin sipas rezultateve. Aktiviteti zhvillohet sipas lojës domino ku njëra pllakë kërkon tjetrën p.sh pllakëza me mbledhorët  $2 + 2$  kërkon pllakëzen tjetër me shumën 4. Ky model i materialit mund të përdoret edhe për veprime tjera matematikore si dhe në lendë tjera.





# MBLEDHJE DHE ZBRITJE - REZULTATET ME PENJ

## REZULTATET

- Mbledhë dhe zbritë
- Zhvillon motoriken fine

## NDËRTIMI

Vizatohet një figurë p.sh. figura e krimbit. Në anën e majtë të figurës shkruhen detyra dhe në anën e djathtë rezultatet. Detyrat me rezultate shkruhen në mënyre paralele dhe tërthorazi. Ndërsa në anën tjetër (prapa) të figurës vizatohen vijat të cilat do të jenë çelësi i rezultatit. Plastifikohet fleta dhe prehet në mënyrë harmonike (një detyrë në një hark). Tek


## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- Markera me ngjyra
- Penj
- Gërshërë

pjesa e sipërme e figurës shpohet një vrimë dhe lidhet peri.

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Nxënësi udhëzohet që perin fillimisht ta vendos tek detyra (p.sh. 3-1), pastaj ta kërkojë rezultatit (p.sh. 2) me anë të perit d.m.th. me pe ta përshkruajë korrelacionin detyrë - rezultat. Kështu i përcjell të gjitha detyrat. Në anën e tjetër nxënësi bën vetëkorrigjimin e detyrës përmes vijave të cilat japin rezultatit e saktë.





# KALENDARARI

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Hamer
- Fletë me ngjyra
- Fletë plastifikuese
- Laps
- Gërshërë
- Velcro

## REZULTATET

- Komunikon me fotografi
- Lexon
- Emerton ditët, datën, muajt, vitin, motin, orën mësimore me radhë etj
- Zhvillon vetedisiplinen përmes rutines ditore .

dhe orët mësimore vizatojmë fotografi që i përgjigjen motit dhe orës mësimore. Printohet ,plastifikohet dhe të gjitha këto prehen në formë të tiketave dhe më pastaj klasifikohen nëpër kuti.

## NDËRTIMI

Mbi hamer shkruhen pjesë të kalendarit si: dita, data, muaji, viti, moti, ora mësimore, klasa dhe kujdestari. Nën secilën karakteristikë të kalendarit vendoset një pjesë e vellcros. Në fleta me ngjyra shkruhen ditët e javës, datat e muajt, muaj, viti, klasa (p.sh. klasa-7) dhe emrat e nxënësve që janë kujdestar të klasës. Kurse për parashikimin e motit

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Pjesa e hamerit e shkruar me pjesët e kalendarit vendoset diku në klasë, dhe nxënësit do udhëzohen se secili me radhe kur e ka radhën e kujdestarisë do të vendos emrin e vete dhe do t'i ndërroi pjesët e kalendarit çdo ditë sipas kërkesës së kalendarit.( sipas ditës , datës, orës mësimore, motit që do jetë atë ditë.







# TABELA E SHUMËZIMIT

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Hamer
- Fletë plastifikuese
- Laps
- Markera me ngjyra
- Gërshërë

## REZULTATET

- Shumëzon numrat me elemente
- Zhvillon logjikën


ndërsa hameri tjetër shërben si tabelë kontrolluese për vetëkorrigjim .

## NDËRTIMI

Dy hamera i prejme në formatin A-3 ku shkruhet tabela e shumëzimit dhe vizatohen figura me elemente sa tregon rezultati. Të dy hamerat me ngjyra të ndryshme plastifikohen. Në njërin hamer prehen figurat si në fotografi,

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT:

Nxënësit udhëzohen të punojnë me tabelën e shumëzimit me figurat e prera. Nxënësi lexon tabelën dhe e shoqëron atë me numrin e elementeve që i përgjigjen rezultatit p.sh.  $2 \times 2 = 4$  dy qershia herë dy qershia barazi me katër qershia.



# BUSULLA ORIENTUESE

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Hamer
- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- Marker
- Gërshërë

## REZULTATET

- Mbledh dhe zbritë deri në 10
- Llogarit shumën dhe ndryshimin e numrave të dhënë në detyrë
- Vendos tiketën në këndin e duhur
- Përgjegjësia në grup

## NDËRTIMI


Mbi hamer tërhiqet një vijë në formë të busullës. Kjo ndahet në disa pjesë (fusha) të barabarta (mundet në 3-4-5...pjesë). Në fletë me ngjyra shkruhen detyra kur dy numra mbliidhen apo zbriten brenda dhjetëshes së parë duke përfshirë edhe numrin zero na e japin rezultatin p.sh 1, 2... Kjo vazhdohet deri të detyrat ku rezultati është 10 të. P.sh.  $3+0$   $0+3$   $2+1$   
 $1+2$   $3-0$   $4-1$   $5-2$   
 $6-3$   $7-4$   $8-5$   $9-6$   
 $10-7$  rezultati këtu është 3. Nga secili rezultat duke filluar nga 1 - 10 do dalin nga 12 tiketa me detyra të mbledhjes dhe zbritjes.

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Vendoset përpara  
nxënësve hameri  
në formë busulle.

Nxënësit ulen rreth hamerit dhe zgjedhin katër numra dhe i vendosin në katër fusha. Tiketat me detyra që përputhen me rezultatin e numrit në fushë shpërndahen përreth busullës në mënyrë të përzier dhe të kthyer mbrapsht. Secili nxënës me radhë do ta tërheq një tiketë dhe do ta lexojë detyrën para grupit dhe pastaj do ta vendos brenda fushës që i takon rezultatit.

Kështu që tiketat edhe pse janë përzier ato prapë do të kthehen në grupin e rezultateve të caktuara. Këtu nxënësit mund të marrin edhe role si: vëzhgues, ndihmës, prezantues etj.





# KONCEPTI I NUMRIT

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Fletë e bardhë
- Letër plastifikuese
- Kapse të drurit
- Gërshërët

## REZULTATET

- Njeh numrat 1 deri në 10
- Klasifikon materialin sipas ngjyrave
- Zhvillon motoriken fine
- Zhvillon koordinimin sy-dorë

të vogla të drurit mbi të cilat ngjitet fleta ngjitëse me ngjyra të ndryshme formojmë elementet e numrave.

## NDËRTIMI

Printohet një fletë me elemente numerike dhe plastifikohet. Merren 10 kapse të drurit dhe secilës i'a ngjesim numrat nga 1 deri ne 10 të cilët mund të formohen me materiale të ndryshme, ndërsa me copëza

## PËRDORIMI I MATERIALIT

Varësisht nga niveli i njohurive të nxënësit bëhet klasifikimi i elementeve sipas ngjyrës duke i vendos në tabelë. Nxënësit që kuptojnë konceptin e numrit lidhin numrin me elementet përkatëse në tabele.



# MË E MADHE MË E VOGËL

## REZULTATET

- Njeh shenjën më e madhe më e vogël
- Përdor shenjat
- Krahason numrat

## NDËRTIMI


Formojmë numra p.sh prej 1 deri në 30. I printojmë ose i shënojmë me dorë dhe pastaj i plastifikojmë. Marrim dy shkopinjtë të akullores, i bashkojmë në një cep duke formuar kështu formën e shenjës më e madhe-më e vogël (< >) ose në formë të shkronjës V. Shkopinj të ngjitur i dizajnojmë sipas dëshirës, në këtë rast janë bërë në formë të gojës së peshkaqenit.

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Kafe, mund të jenë edhe (fara të ndryshme)
- Fletë plastifikuese
- Shkopinj të akullores
- Ngjyra
- Gërshërë

## PËRDORIMI I MATERIALIT

Në një fletë të bardhë vendosen dy numra. Nxënësi vendos elementet që përcakton numri, pastaj vendos shenjën në pozicionin e duhur (< >). Nxënësit do ta kuptojnë më lehtë konceptin e madhe e vogël kur ju themi se në atë anë ku peshkaqeni ka hapur gojën duhet të ketë elemente më shumë sikur në foto. Si elemente tjera mund të përdorim : kafe, fasule, oriz, makaron, far arre, kumbullës, etj.







# TABELA PËR LLOGARITJE

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Letër e bardhë
- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikuse
- Velcro
- Gërshërë

## REZULTATET

- Njeh konceptin e numrit
- Mbledh me elemente


## NDËRTIMI

Nënjefletë A3 vizatohet tre katrorë. Poshtë tyre tërheqim vijat ku do të vendosën numrat dhe shkruajmë shenjat paralelisht me vija (+, =) dhe e plastifikojmë. Brenda kornizave vendosim velcro sipas dëshirës. Në një fletë me ngjyrë vizatojmë mollat si elemente të cilat i pastifikojmë dhe i prejme në madhësi të njëjtë. Në të njëjtën

procedurë i punojmë edhe numrat. Velcro ngjitet brenda hapësirave të caktuar në tabelë, në numra dhe në elemente.

## PËRDORIMI I MATERIALIT

Elementet me molla vendosen nga mësuesja në tabelën llogaritëse. Nxënësi numëron elementet dhe përcakton numrin të cilin e vendos në vijën poshtë katrorit. Në bazë të mbledhjes së elementeve nxënësi gjen rezultatin dhe vendos numrin.





# ZBULIMI I FIGURËS

## REZULTATET

- Zhvillon logjikën
- Vendos copëzat e njëjtë mbi sipërfaqe
- Shpalos copëzat me radhë
- Zhvillon motoriken fine

## NDËRTIMI



Në hamer vizatohen katrorë të barabartë (katër vertikalisht dhe katër horizontalisht), gjithsejtë gjashtëmbëdhjetë katrorë. Zgjidhet një figurë që do ta vizatojmë brenda tyre. Figura duhet të jetë e njëjtë për secilin katrorë, por e vendosur në pozita të ndryshme d.m.th. secili katrorë ka pozitën e vetë të figurës. Secilit katrorë në pjesën e poshtme, në anën e djathtë i vendoset një pikë. Materiali duhet të bëhet në dy kopje identike, mirëpo kopjes së dytë duhet t'i vizatohet një fotografi mbrapa dhe pastaj plastifikohen dhe priten në katrorë të barabartë.

## MATERIALI I NEVOJSHËM

- Hamer
- Letër me ngjyrë
- Fletë plastifikuese
- Laps
- Ngjyra
- Gërshërë
- Vizore

## MËNYRA E PËRDORIMIT TË MATERIALIT

Mësuesja vendos materialin përpara nxënësit. I demonstron se në pjesën bazë ka 16 katrorë, por edhe 16 katrorë tjerë, të cilët janë identik me pjesën bazë. Nxënësi udhëzohet të gjejë identiken e secilit katrorë dhe ta vendos mbi pjesën bazë. Mund ta orientojmë se pika në katrorë duhet të jetë poshtë. Pasi t'i gjejë të gjithë katrorët identik, ata largohen një nga një me radhë, duke filluar nga ana e djathtë në drejtim të së majtës dhe duke i kthyer mbrapa, gjithnjë duke mos e humbur radhën. Duke i ndjekur këta hapa, zbulohet fotografia e plotë e vizatuar mbrapa katrorëve. Ky është çelësi i rezultatit. Përndryshe kjo pjesë mund të përdoret edhe si puzzle.





## FALËNDERIM

Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë -Divizionit për arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta - falënderim për mbështetje financiare për botimin e doracakut. Falënderim të veçantë shprehim për drejtoreshën e qendrës sonë, znj. Igballe Asllani Potera, e cila e përkrahu idenë për hartimin e këtij doracakut dhe na mbështeti në të gjitha aspektet gjatë kohës së punimit të tij.

Falënderojmë mesimdhënëset të cilat kontribuan me materialet e tyre, me realizimin, me strukturimin e këtij doracakut, që do të jetë në shërbim të mesimdhënësve dhe prindërve për t'ua lehtësuar punën me nxënësit-fëmijët e tyre.

- |  |                                      |
|--|--------------------------------------|
| 1. Feride Salihu Gashi- koordinatore e ekipit për prodhim të materialeve | 11. Dafina Ademi - mësuese udhëtuese |
| 2. Makfirete Bytyçi  | 12. Valbona Berisha                  |
| 3. Blerina Halilaj - psikologe   | 13. Ganimete Lahu                    |
| 4. Naxhije Zakuti  | 14. Adelina Çitaku                   |
| 5. Mimozë Musliu - pedagoge  | 15. Vjollca Deliu                    |
| 6. Lirije Vitija Reqica - mësuese udhëtuese                              | 16. Vlora Kosumi                     |
| 7. Albana Haliti - Selmani   | 17. Melihate Zabeli                  |
| 8. Edona Sopi -Sagdani   | 18. Donjeta Xhaferi                  |
| 9. Hyra Salihu - Zeka - mësuese udhëtuese                                | 19. Valbona Berisha                  |
| 10. Hava Bahtiri   | 20. Valentina Ahmeti                 |
|  | 21. Vjollca Shabani                  |
|  | 22. Abetare Kafexholli               |
|  | 23. Shqiponjë Semetishti             |



